



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova



Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KOMUNA E PODUJEVËS
DREJTORIA PËR KULTURË, RINI DHE SPORT
Datë 06.10.2023

Bazuar në nenin 62 pika 3, të ligjit për vetëqeverisje lokale nr. 03/L-040. Rregulloren MF-Nr.04/2017, mbi kriteret standarte dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, neni 61 paragrafi 1 dhe 2 të statutit të Komunës së Podujevës nr. 01-020/01-0050862/18 dhe Vendimit të Kryetarit të Komunës për shpalljen e thirrjes publike për mbështetje financiare publike për projektet, programeve të organizatave joqeveritare në Komunën e Podujevës nr. Protokollit 02-401/01-0073220/23 datë 05.10.2023.

THIRRJE PUBLIKE

Për ofrimin e mbështetjes financiare publike për financimin e projektpropozimeve të Klubeve dhe Shoqatave sportive, për organizimin e aktiviteteve sportive në Komunën e Podujevës

1. Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport në Komunën e Podujevës u bënë thirrje të gjithë Klubeve, Shoqatave sportive të regjistruara në Komunën e Podujevës, programi i punës i të cilave është i fokusuar te fushat sportive, të aplikojnë për mbështetje financiare për projektet që kontribuojnë në zhvillimin dhe masivizimin e sportit dhe organizimin **gjithnjë duke u bazuar në politikat programore të Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, në Komunën e Podujevës.**
2. Klubet, Shoqatat sportive, në përputhje me këtë thirrje publike mund të aplikojnë me projektpropozimet për organizimin e aktiviteteve sportive.
3. Klubet, Shoqatat sportive – mund të aplikojnë me një projekt që kontribuojnë në organizimin e fushave - sportive, përmes aktiviteteve si më poshtë:

Veprimtaritë:

- **Ngritja e kapacitetit në fushën e sportit**
 - Përkrahje e klubeve sportive që garojnë në nivel seniorësh në ligat e Republikës së Kosovës;
 - Përkrahje klubeve të suksesshme;
 - Ngritje e nivelit profesional të klubeve sportive;
 - Ngritje e cilësisë dhe konkurrueshmërisë.



4. Vlera totale e planifikuar e thirrjeve për subvencione për këtë vit është 20,000 € (Euro).

Shuma minimale e mbështetjes financiare që mund të alokohet për çdo projekt është 500 € (Euro), ndërsa shuma maksimale për një projekt është 2,000 € (euro).

5. Afati për dorëzimin e propozimeve është 15 ditë pune, pra nga dt. 07.10.2023 dhe përfundon me datën 27.10.2023.

6. Klubet, Shoqatat sportive, mund të aplikojnë vetëm me një projekt.

Periudha e zbatimit të projektit është tetor 2023 - dhjetor 2023.

Kriteret për pjesëmarrje në thirrjen publike të subvencioneve për Sport:

- Klubet, Shoqatat sportive, të cilat veprojnë në Komunën e Podujevës dhe realizojnë aktivitetin e tyre në Komunën e Podujevës.
- Klubet, Shoqatat sportive, kanë të drejtë aplikimi vetëm nëse marrin pjesë në gara të rregullta në kampionat të Kosovës në sporte gjegjëse në nivel të **seniorëve**
- Klubet, Shoqatat sportive, të cilët nuk kanë përmbyllur raportin e subvencioneve të thirrjeve paraprake nuk kanë të drejtë të përfitojnë nga subvencionet e Komunës së Podujevës në këtë thirrje.
- Të mos kenë pranuar mjete nga burime tjera të financimit për të njëjtat aktivitete.
- Të mos ekzistoj ndonjë konflikt interesi në mes të aplikuesit, përkatësisht përfaqësuesve/udhëheqësit të aplikuesit dhe organizatës buxhetore apo institucionit publik, siç parashihet me legjislacionin në fuqi në Republikën e Kosovës.
- Të drejtë aplikimi me projektet e tyre kanë Klubet, Shoqatat sportive, që janë të regjistruara si OJQ, në Komunën e Podujevës.

Klubet, Shoqatat sportive, aplikuese duhet të dëshmojnë se programi i tyre i punës është i fokusuar në fushat si të cekura më lartë. Po ashtu të kenë kryer transaksionet financiare në mënyrë transparente sipas legjislacionit për në Republikën e Kosovës dhe në përputhje me rregullat e kontabilitetit si dhe të kenë përmbushur detyrimet kontraktuale ndaj Komunës së Podujevës dhe të gjithë ofruesëve tjerë të mbështetjes financiare publike.

Procesi i pranimit, hapjes dhe shqyrtimit të aplikacioneve, vlerësimit të aplikacioneve, kontraktimi, dhënia e fondeve, koha dhe mënyra e parashtrimit të ankesave, trajtimi i dokumenteve dhe kalendari tregues i zbatimit të thirrjes, janë të



detajuara në [Rregulloren për subvencione](#).

Kujdes: Aplikacionet, të cilat nuk e kanë dokumentacionin e kompletuar do të diskualifikohen.

Dokumentet nuk pranohen pas mbylljes së thirrjes publike. Ngarkimi i dokumentit të gabuar konsiderohet si mungesë e dokumentit.

Nuk do të pranohet ndryshimi i subjektit të aplikantit nga individ në cilindo variant tjetër, pas përfundimit të aplikimit. E njëjta vlejn edhe për ndryshim të xhirollogarisë.

Të gjithë aplikantët të cilët kanë ndërruar të dhënat e tyre duhet të sigurohen që t'i përditësojnë informatat e tyre në sistem gjatë periudhës së afatit të aplikimit për subvencione.

Do të konsiderohen për mbështetje financiare vetëm projektet që janë pranuar brenda afatit të paraparë me këtë thirrje publike, dhe të cilat i përmbushin plotësisht kushtet e përcaktuara sipas thirrjes publike.

Lista e dokumenteve të thirrjes publike

➤ **Për klube/shoqata:**

- Çertifikata e regjistrimit të OJQ-së;
- Çertifikata e nr. fiskal;
- Vërtetimi/Konfirmimi i llogarisë bankare të OJQ-së (nuk pranohet kopje e kartelës bankare);
- Kopjen e letërnjoftimit/ pasaportës të përfaqësuesit të OJQ-së.
- Vërtetimin që OJQ/klubi/shoqata nuk ka obligime tatimore (nga ATK).
- Vendimin e regjistrimit të klubit/shoqatës në DKRS.
- Deklarata e partneritetit. <https://kk.rks-gov.net/podujeve/wp-content/uploads/sites/25/2023/10/DEKLARATA-E-PARTNERITETIT-2023.doc>
- Deklarata për financimin e dyfishtë <https://kk.rks-gov.net/podujeve/wp-content/uploads/sites/25/2023/10/DEKLARATE-MBI-FINANCIMIN-E-DYFISHTTE-2023.docx>
- Formulari i sportit <https://kk.rks-gov.net/podujeve/wp-content/uploads/sites/25/2023/10/3-Formulari-per-Sport.docx>
- Formulari i projekt propozim thirrjes publike. <https://kk.rks-gov.net/podujeve/wp-content/uploads/sites/25/2023/10/Formulari-i-Projekt-Propozimit-i-thirrjes-publike.docx>
- Formulari i propozim buxhetit. <https://kk.rks-gov.net/podujeve/wp-content/uploads/sites/25/2023/10/FORMULARI-I-PROPOZIM-BUXHETIT-2023.docx>

Vërejtje/Kujdes:

- ❖ **Raporti Narrativ** - i cili përfshin dëshmi nga projekti i aktivitetit qoftë nëpërmjet dëshmive të fotografimit. Ky raport duhet të plotësohet dhe të nënshkruhet nga Personi që ka nënshkruar marrëveshjen për subvencione. Raporti duhet të dorëzohet pas përfundimit projektit.

Raporti narrativ i përgatitur duhet deklarohet dhe:



- ❖ Të përfshijë dokumentacion mbështetës (si foto, regjistrime të ndryshme të aktiviteteve, etj).
- ❖ Të nënshkruhet nga një person në pozicion drejtues të subjektit grantmarrës.
- ❖ **Raporti Financiar** – kërkohet që të përmbushen obligimet e raportit financiar njëjtë sikurse të gjitha subjektet tjera juridike. Në përputhje me Ligjin nr. 04/L-57 të gjitha OJQ-të e regjistruara në Departamentin për OJQ, të cilave në vazhdim i'u është dhënë Statusi i Përfitimit Publik duhet të përgatisin një raport vjetor të projektit.

Raporti financiar i përgaditur duhet deklarohet dhe:

- ❖ Të përshkruajë shpenzimet në përputhje me buxhetin origjinal duke reflektuar shpenzimet e kërkuara dhe ato të kryera
- ❖ Të përshkruajë çdo pajisje të blerë.
- ❖ Të evidentojë çdo fond të pashpenzuar (të cilat duhet të kthehen ose për të cilat kërkohet shtyrje e afatit të përdorimit).
- ❖ Të nënshkruhet nga një person në pozicion drejtues.
- ❖ Të gjitha aplikimet të cilat nuk do të kenë dokumentacionin e kompletuar nuk do të merren parasysh.
- ❖ Ju lutemi që projekt propozimin ta shkruani në **formë elektronike**, (të printuara). **Projekt propozimet me dorëshkrim nuk pranohen.**
- ❖ Dokumentat e kompletuar dërgohen në zyrën pritëse, kati i parë në Komunën e Podujevës, **në zarfe të mbyllura.**
- ❖ Nuk do merren në shqyrtim Klubet/Shoqatat sportive, të cilat nuk janë treguar të përgjegjshme në deklaramin dhe formën e mbajtjes së aktivitetit në vitin kalues.

Drejtorja për Kulturë, Rini dhe Sport
Rruga "Nuhi Gashi" Podujevë

Në zarf të shkruhet qartazi:

Drejtuar Zyrës së Shërbimit për qytetarë në Komunën e Podujevës:
Aplikim në kuadër të Thirrjes për projekt-propozime për vitin 2023
Emri i aplikantit: _____
Titulli i projektit: _____

DREJTORIA PËR KULTURË, RINI DHE SPORT, DO TË VAZHDOJ PROCEDURAT E REALIZIMIT TË THIRRJES PUBLIKE KONFORM DISPOZITAVE TË PËRCAKTUARA LIGJORE.

DREJTOR
për Kulturë, Rini dhe Sport



